



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

TESTI I MATURËS

GJIMNAZI SHKENCA NATYRORE

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

MATEMATIKË

FIZIKË

KIMI

BIOLOGJI




Prishtinë, qershor 2015

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t'ju përgjigjeni 80 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'ju përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.




6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'ju përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

MATEMATIKË

1. Cili është ekuacioni i drejtëzës d , e dhënë në figurë?

- A. $d: 4x + 5y + 20 = 0$
- B. $d: 5x + 4y - 20 = 0$
- C. $d: 5x - 4y + 20 = 0$
- D. $d: 4x - 4y - 20 = 0$



2. Një nxënës në Testin e Maturës Shtetërore ka arritur këtë numër të përgjigjeve të sakta: Gjuhë amtare (37 nga 50), Gjuhë angleze (33 nga 40), Matematikë (20 nga 30). Sa % të pikëve i ka arritur ai nxënës në Testin e Maturës Shtetërore?

- A. 55%
- B. 65%
- C. 75%
- D. 85%

3. Cila është zgjidhja e ekuacionit $\log_2(2\log_x(2x-3)) = 1$?

- A. 0
- B. 1
- C. 2
- D. 3

4. Funkcionet f dhe g janë dhënë në mënyrë tabelare, për të cilat kompozimi është përkufizuar me $(f \circ g)(x) = g(f(x))$.

x	1	2	3	4
$f(x)$	3	4	2	1

x	1	2	3	4
$g(x)$	4	1	3	2

Sa është $(f \circ g)(3)$?


- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4

5. Në një zyrë pune, temperatura kontrollohet me një termostat elektronik. Temperatura ndryshon sipas funksionit $y = 19 + 6\sin\left(\frac{\pi}{12}(x-11)\right)$, ku y është temperatura në $^{\circ}\text{C}$ dhe x është numri i orëve pas mesnatës. Sa është temperatura në zyrë, në ora 9:00 të mëngjesit?

- A. 14°C
- B. 16°C
- C. 18°C
- D. 20°C

6. Cili është ekuacioni i rrethit të paraqitur në figurën?

- A. $(x + 2)^2 + (y - 1)^2 = 25$
- B. $(x - 2)^2 + (y + 1)^2 = 25$
- C. $(x - 7)^2 + (y - 1)^2 = 25$
- D. $(x - 3)^2 + (y - 7)^2 = 25$



7. Sa është $\lim_{x \rightarrow 9} \frac{\sqrt{x} - 3}{x - 9}$?

- A. 0
- B. ∞
- C. $\frac{1}{6}$
- D. $\frac{1}{9}$

8. Një punëtor në ditën e parë mblodhi 40 kg dredhëza, ndërsa për çdo ditë tjetër ai mblodhi nga 5 kg më shumë se në ditën paraprake. Për çdo kilogram dredhëzash të mblledhura paguhej me nga 0.2 €. Sa euro i fitoi punëtori për 10 ditë pune?

- A. 127 €
- B. 125 €
- C. 135 €
- D. 137 €

9. Është dhënë tabela:

x	$f(x)$	$f'(x)$	$g(x)$	$g'(x)$
1	2	-1	1	1
2	1	1/2	2	1
3	3	2	3	1

Sa është $h'(2)$ nëse $h(x) = f(x) - g(x)$?

- A. $-\frac{1}{2}$
- B. $\frac{1}{2}$
- C. $-\frac{1}{3}$
- D. $\frac{1}{3}$

10. Cila është domena (bashkësia e vlerave) e funksionit $f(x) = \frac{\sqrt{x+4}}{1-x}$?

- A. $D(f) = (1, \infty)$
- B. $D(f) = (-\infty, 1) \cup (1, 4)$
- C. $D(f) = [-4, 1)$
- D. $D(f) = [-4, 1) \cup (1, \infty)$


FIZIKË

11. Si quhet rrymimi i fluidit në rast se vijat e rrymimit janë paralele mes veti?

- A. Jostacionar
- B. Laminar
- C. Stacionar
- D. Turbulent

12. Një makinë lëvizë nëpër trajektore me rreze (r) si në figurë. Në cilin nga drejtimet e horizontit është vektori i shpejtësisë lineare (v)?

- A. Veri
- B. Jug
- C. Lindje
- D. Perëndim



13. Për cilën nga madhësitë fizike N (Njutni) është njësi matëse?

- A. Energjinë
- B. Shtypjen
- C. Peshën
- D. Masën

14. Një tel i drejtë lëvizë duke rritur shpejtësinë normal me vijat e fushës magnetike si në figurë. Çka ndodh me tensionin në skajet e përçuesit?

- A. Nuk ndryshon
- B. Bëhet zero
- C. Zvogëlohet
- D. Rritet



15. Sa do të jetë energjia potenciale e ngarkesës me masë $m = 5\text{kg}$ nëse ajo ngritet në lartësinë

$$h = 2\text{m} \text{ dhe nëse } g = 10 \frac{\text{m}}{\text{s}^2} ?$$


- A. 1000J
- B. 100J
- C. 10J
- D. 1J

16. Me çfarë shpejtësie përhapet vala longitudinale me gjatësi valore $\lambda = 2\text{m}$ dhe frekuencë $\nu = 100\text{Hz}$?

- A. $v = 200 \frac{\text{m}}{\text{s}}$
- B. $v = 0.02 \frac{\text{m}}{\text{s}}$
- C. $v = 0.2 \frac{\text{m}}{\text{s}}$
- D. $v = 50 \frac{\text{m}}{\text{s}}$

17. Në figurën e mëposhtme janë paraqitur dy valë që përhapen në mjedis të njëjtë, me shpejtësi të barabarta, në drejtim të njëjtë por me kahje të kundërta. Cila dukuri do të paraqitet kur valët gjenden ndërmjet pikave C dhe D ?

- A. Difraksioni
- B. Polarizimi
- C. Efekti i Doplerit
- D. Interferenca e valëve



18. Në enën e mbyllur më vëllim V_0 gjenden N_0 molekula të një gazi ideal me ç' rast përqëndrimi i molekulave do të jetë n_0 . Sa do të jetë përqëndrimi i molekulave të gazit të njëjtë me numër të njëjtë N_0 nëse vëllimi i enës dyfishohet?

- A. $n = 2n_0$
- B. $n = \sqrt{2}n_0$
- C. $n = \frac{n_0}{2}$
- D. $n = \frac{n_0}{\sqrt{2}}$

19. Çfarë pune kryhet në enën e mbushur me gaz në shtypje konstante, nëse rritet vëllimi i enës nga V_1 në $V_2 = mV_1$?

- A. $A = (m-1) pV_1$
- B. $A = mp V_1$
- C. $A = (m+1) pV_1$
- D. $A = (1-m) pV_1$

20. Nëse shufra e njëjtë metalike me gjatësi dhe temperaturë fillestare të njëjtë i nënshtrohet veprimit të nxehtësisë për katër herë asaj do t'i ndryshojë temperatura. (shih tabelën). Në cilin nga rastet ndodh ndryshimi maksimal i gjatësisë së shufrës?

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4

Nr.	$\Delta t = t - t_0$
1	5°C
2	50°C
3	$\frac{1}{5}^\circ\text{C}$
4	$\frac{1}{50}^\circ\text{C}$


21. Në pjesën nënujore të anijes në thellësinë $h = 5m$ është krijuar një hapje me sipërfaqe $S = 0,01m^2$. Sa duhet të jetë forca minimale e veprimit në hapje që të mos lejohet futja e ujit në anije, nëse densiteti i ujit merret $\rho = 1000 \frac{kg}{m^3}$, ndërsa nxitimi i gravitetit

$$g = 10 \frac{m}{s^2} ?$$

- A. $5N$
- B. $50N$
- C. $500N$
- D. $5000N$

22. Cila nga këto thjerra përdoret te syzet kur kemi dioptri pozitive (shih.fig.) ?


- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV



23. Në cilin nga rastet kemi burim të fushës magnetike?

- A. Kur një grimcë neutrale lëvizë në vijë të drejtë
- B. Kur një grimcë neutrale lëvizë në trajektore rrethore
- C. Kur një grimcë e elektrizuar nuk lëvizë
- D. Kur një grimcë e elektrizuar lëvizë

24. Nëse një rreze drite kalon nga ajri në qelq nën këndin e rënies 0° , atëherë cili nga pohimet vijuese është i saktë?




- A. Drejtimi i përhapjes së rrezeve të dritës ndryshon, ndërsa shpejtësia e rrezeve të dritës mbetet e njëjtë
- B. Shpejtësia e rrezeve të dritës zvogëlohet, ndërsa drejtimi i rrezeve të dritës mbetet i njëjtë
- C. Shpejtësia e rrezeve të dritës mbetet e njëjtë, ndërsa drejtimi i rrezeve të dritës ndryshon
- D. Drejtimi i përhapjes së rrezeve të dritës mbetet i njëjtë, ndërsa shpejtësia e rrezeve të dritës në qelq rritet

25. Cila nga formulat e shënuara paraqet shpejtësinë e një vale?

- A. $v = \frac{\lambda}{T}$
- B. $v = \frac{T}{\lambda}$
- C. $v = \lambda \cdot T$
- D. $v = \lambda^2 \cdot T$

26. Në figurë janë paraqitur dy valë A dhe B të cilat përhapen në të njëjtin mjedis. Cila nga karakteristikat është e njëjtë për të dy valët ?

- A. Perioda
- B. Amplituda
- C. Frekuenca
- D. Gjatësia valore




27. Në figurë është paraqitur një pirun akustik i cili kryen dridhje në ajër. Rrathët e vegjël paraqesin molekulat e ajrit që e bartin valën e zërit.




Cili nga rastet e mëposhtme paraqet drejtimin e lëvizjes së molekulave të ajrit?

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4



28. Cila nga formulat e shënuara paraqet ligjin e Omit për qarkun në figurë?

- A. $I = \frac{\varepsilon_1 + \varepsilon_2}{R}$
- B. $I = \frac{\varepsilon_1 + \varepsilon_2}{2R}$
- C. $I = \frac{\varepsilon_1 - \varepsilon_2}{2R}$
- D. $I = \frac{\varepsilon_1 - \varepsilon_2}{R}$



29. Në një enë të mbyllur gjenden dy gazra oksigjeni dhe hidrogjeni. Nëse shtypjet parciale të tyre janë 50 kPa përkatësisht 40 kPa, atëherë sa do të jetë shtypja e përgjithshme e kësaj përzierje ?

- A. 10 kPa
- B. -10 kPa
- C. 90 kPa
- D. -90 kPa

30. Dy sfera metalike A dhe B janë të elektrizuara me sasi të elektricitetit si në figurë. Nëse këto dy sfera takohen me njëra tjetrën dhe pastaj ato ndahen nga njëra tjetra sa do të jetë sasia e elektricitetit në sferën A?

$-3 \times 10^{-6} \text{ C}$ $-3 \times 10^{-6} \text{ C}$



- A. $-3 \cdot 10^{-6} \text{ C}$
- B. $+3 \cdot 10^{-6} \text{ C}$
- C. $-6 \cdot 10^{-6} \text{ C}$
- D. $+6 \cdot 10^{-6} \text{ C}$

31. Cili grup në sistemin periodik të gjitha elementet i ka gazra?

- A. Grupi 15
- B. Grupi 16
- C. Grupi 17
- D. Grupi 18


32. Numri i komponimeve organike në jetën e përditshme është shumë i madh:

- A. sepse atomet e karbonit lidhen në mes veti në disa mënyra
- B. sepse atomet e karbonit lidhen me të gjitha elementet kimike
- C. sepse ekzistojnë katër modifikime alotropike të atomit të karbonit
- D. sepse karboni formon komponime me lidhje jonike dhe lidhje kovalente

33. Cili oksid kur tretet në ujë letrën e kaltër të lakmusit e shndërron në të kuqe ?


- A. CO
- B. SO₃
- C. Na₂O
- D. CaO

34. Gjatë procesit të fotosintezës energjia diellore shndërrohet në energji kimike dhe zhvillohet reaksioni kimik:



Sa gram glukozë (C₆H₁₂O₆) do të përftohen nëse gjatë këtij reaksioni janë absorbuar 5632 kJ? Nëse: Ar(C)=12.0, Ar(H)=1.0, Ar(O)=16.0

- A. 360 g
- B. 180 g
- C. 90 g
- D. 45 g



35. Cili sheqer identikohet me reagjent të Fehlingut?


- A. Eritruloza
- B. Ribuloza
- C. Riboza
- D. Sorboza

36. Sa është numri oksidues i oksigjenit në jonin bikarbonat HCO₃⁻?

- A. -1
- B. -2
- C. -3
- D. -4

37. Cili është emri i këtij komponimi i cili është i paraqitur me formulën strukturore?

- A. Glicina
- B. Alanina
- C. Leucina
- D. Serina



38. Çfarë rrjete kristalore ka kloruri i natriumit?

- A. Rrjetë kristalore metalike
- B. Rrjetë kristalore kovalente
- C. Rrjetë kristalore molekulare
- D. Rrjetë kristalore jonike

39. Cili nga reaksionet e mëposhtme paraqet reaksion të formimit të precipitatit (fundërrinës)?


- A. $\text{AgCl} + 2\text{NH}_3 = [\text{Ag}(\text{NH}_3)_2]\text{Cl}$
- B. $\text{AgNO}_3 + \text{NaCl} = \text{AgCl} + \text{NaNO}_3$
- C. $\text{Cr}(\text{OH})_3 + 3\text{HCl} = \text{CrCl}_3 + 3\text{H}_2\text{O}$
- D. $\text{Cr}(\text{OH})_3 + 3\text{NaOH} = \text{Na}_3[\text{Cr}(\text{OH})_6]$

40. Sa protone dhe sa elektrone ndodhen në jonin e azotit $^{14}_7\text{N}^{3-}$?

- A. 7 protone dhe 10 elektrone
- B. 7 protone dhe 4 elektrone
- C. 14 protone dhe 10 elektrone
- D. 14 protone dhe 7 elektrone


41. Nikotina është ndër alkaloidet kryesore e cila gjendet në gjethet dhe rrënjët e duhanit, dhe në mjekësi shërben si stimuluese e frymëmarrjes, ndërsa në sasi të mëdha shkakton paralizën e frymëmarrjes dhe vdekjen. Cila është formula strukturore e nikotinës?

- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV



42. Cili lloj i izomerisë paraqitet në komponimet vijuese ?

- A. Izomeria e grupeve funksionore
- B. Izomeria konformacionale
- C. Izomeria pozicionale
- D. Izomeria optike



43. Në cilin balon ka numër më të madh të molekulave?

- A. Në balonin I
- B. Në balonin II
- C. Në balonin III
- D. Në balonin IV



44. Cila nga këto kripëra hidrolizon si bazë?

- A. NaCl
- B. KBr
- C. KCN
- D. NH_4Cl

45. Çka ndodhë gjatë përfutimit të alkooleve nga aldehidet?

- A. Reduktohet atomi i karbonit i grupës karbonile
- B. Oksidohet atomi i karbonit i grupës karbonile
- C. Oksidohet atomi i karbonit që është afër grupës karbonile
- D. Reduktohet atomi i karbonit që është më sa largu nga grupa karbonile

46. Cili element i grupit të 14-të e ka temperaturën e shkrirjes më të ulët?

- A. Karboni (C)
- B. Silici (Si)
- C. Kallaji (Sn)
- D. Germaniumi (Ge)


47. Kevlari është polimer i cili ka fortësi të madhe dhe përdoret edhe në rrobat antiplumb. Për nga përbërja kimike çfarë komponimi është kevleri ?

- A. Polisaharid
- B. Poliamid
- C. Polietilen
- D. Poliizopren

48. Joni i magnezit (${}_{12}\text{Mg}^{2+}$) në krahasim me atomin e magnezit (${}_{12}\text{Mg}$) përmban:

- A. 2 protone më shumë
- B. 2 elektrone më shumë
- C. 2 protone më pak
- D. 2 elektrone më pak

49. Cila nga substancat kimike në shembullin vijues paraqet mjetin reduktues ?







- A. H_2 sepse oksidohet deri në H^+
- B. Cu^{2+} sepse reduktohet deri në Cu^0
- C. Cu^{2+} sepse oksidohet deri në Cu^0
- D. H_2 sepse reduktohet deri në H^+

50. Kalciumi i takon të njëjtit grup të elementeve të sistemit periodik sikurse magnezi. Cili nga pohimet vijuese i përgjigjet kalciumit?

- A. Formon oksid acidik CaO
- B. Reagon vrullshëm me ujën dhe liron hidrogjenin
- C. Formon oksid bazik Ca_2O_3
- D. I takon grupit të metaleve alkaline

51. Cili nga këto komponime ka veti më të dobëta bazike?


- A. Komponimi A
- B. Komponimi B
- C. Komponimi C
- D. Komponimi D




52. Statuja e lirisë në New York është e ndërtuar nga bakri, i cili është më i qëndrueshëm ndaj korrozionit. Pas një kohe bakri është oksiduar dhe statuja ka marrë ngjyrë të gjelbër si rezultat i formimit të komponimit kimik të:

- A. $\text{Cu}(\text{OH})_2$
- B. $\text{Cu}_2(\text{OH})_2\text{CO}_3$
- C. CuCO_3
- D. CuSO_4


53. Cila është formula strukturore e acidit acetilsalicilik ose aspirinës ?




1



2



3



4

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4

54. Nëse në 200 cm^3 tretësirë të NaNO_3 me përqëndrim në masë $\gamma=160 \text{ g/dm}^3$ janë shtuar 600 cm^3 ujë, sa do të jetë përqëndrimi i tretësirës së fituar ?

- A. $\gamma=53.3 \text{ g/dm}^3$
- B. $\gamma=40 \text{ g/dm}^3$
- C. $\gamma=480 \text{ g/dm}^3$
- D. $\gamma=640 \text{ g/dm}^3$



55. Cili nga elementet e periodës 2 të sistemit periodik ka energji të afinitetit më të madhe?

- A. Litiumi
- B. Neoni
- C. Oksigjeni
- D. Bori

1 H							2 He
3 Li	4 Be	5 B	6 C	7 N	8 O	9 F	10 Ne
11 Na	12 Mg	13 Al	14 Si	15 P	16 S	17 Cl	18 Ar
19 K	20 Ca	31 Ga	32 Ge	33 As	34 Se	35 Br	36 Kr
37 Rb	38 Sr	49 In	50 Sn	51 Sb	52 Te	53 I	54 Xe

BIOLOGJI

56. Si quhen qelizat që marrin pjesë në këmbimin e gazrave në organizëm?

- A. Osteocyte
- B. Eritrocite
- C. Miocyte
- D. Leukocyte

57. Cili organ ndërlidhet saktë me funksionin e tij që e kryen?

- A. Mezonefrosi → Këmbimi i gazrave
- B. Mëlçia → Insulina
- C. Tiroidea → Hormoni T3
- D. Truri i mesëm → Drejtpeshimi

58. Cikli pentozik fillon me glukozë-6-fosfat dhe përfundon me:


- A. glukozë- 3-fosfat
- B. glukozë- 4-fosfat
- C. glukozë- 5-fosfat
- D. glukozë- 6-fosfat

59. Në cilin nga këto biome jeton bizoni si bimëngrënës?

- A. Stepe
- B. Shkretëtira
- C. Pyje tropikale
- D. Pyje gjethegjera

60. Për cilën gjëndër bëhet fjalë nëse kemi këto të dhëna?

- A. Mëlçia
- B. Epifiza
- C. Hipofiza
- D. Pankreasi



61. Nëse vie deri te kryqëzimi i grurit me kërcell të gjatë TT me grurin me kërcell të shkurtër tt, çfarë përqindje të kërcellit të shkurtër do të kenë pasardhësit e gjeneratës F₂?

- A. 25%
- B. 33%
- C. 50%
- D. 75%

62. Skeleti i kurrizit i takon:

- A. skeletit lëkuror
- B. skeletit boshtor
- C. skeletit të brezeve
- D. skeletit të gjymtyrëve

63. Cilat organele qelizore i sintetizojnë proteinat?

- A. Plastidet
- B. Lizozomet
- C. Ribozomet
- D. Centrozomet

64. Si quhet kromozomi kur njëri krah i tij është më i madh ndërsa tjetri krah është shumë më i vogël?

- A. Akrocentrik
- B. Submetacentrik
- C. Metacentrik
- D. Teleocentrik



65. Te cili nga indet e poshtëshënuara shfaqen probleme në funksionimin normal të tij, nëse dëmtohet miozina?

- A. Indi i ashtit
- B. Indi i nervit
- C. Indi i gjakut
- D. Indi i muskulit

66. Cilit grup sistematik të organizmave shtazorë i takon lakuriqi?

- A. Gjitarëve
- B. Ujëtokësorëve
- C. Zvarranikëve
- D. Shpendëve



67. Daltonizmi ose verbimi për ngjyra, shkaktohet nga mutacioni recesiv i gjenit që ndodhet në:

- A. kromozomin 6
- B. kromozomin X
- C. kromozomin 13
- D. kromozomin 21

68. Cilës familje i takon dëllinja e zezë e paraqitur në figurë?

- A. Familjes kryqore
- B. Familjes tisore
- C. Familjes selviore
- D. Familjes pishore



69. Nga cila fletëzë embrionale te njeriu zhvillohen gjëndrat pështymore, mëlçia dhe pankreasi ?

- A. Ektoderma
- B. Endoderma
- C. Epiderma
- D. Mezoderma

70. Cilat nga këto qeliza janë me specializim të lartë gjatë tërë jetës?

- A. Qelizat nervore
- B. Eritrocitet
- C. Qelizat sekretore
- D. Leukocitet

71. Përmes cilit proces bëhet kalimi i dioksidit të karbonit nga gjaku në alveole?

- A. Osmozës
- B. Difuzionit
- C. Transportit pasiv
- D. Transportit aktiv

72. Cilat shtazë përveç lëkurës kanë edhe një mbështjellës të trupit që quhet mant?


- A. Sfungjerët
- B. Shpendët
- C. Butakët
- D. Grykorët

73. Si quhet marrëdhënia e gaforres (A) me balenën (B), pozitive për organizmin A dhe neutrale për organizmin B?

- A. Komensalizëm
- B. Protokooperim
- C. Mutualizëm
- D. Neutralizëm

74. Në figurë është paraqitur ndërtimi i sistemit veshkor te njeriu. Cili organ është i dhënë me numrin 5 ?

- A. Uretra
- B. Ureteri
- C. Veshka
- D. Fshikëza



75. Cilat nga këto grupe të shtazëve e kanë sistemin e hapur të qarkullimit të gjakut?

- A. Skrrajat unazore
- B. Zvarranikët
- C. Insektet
- D. Sisorët

76. Në cilën strukturë të syrit gjenden shkopinjtë dhe konet?

- A. Sklerotide
- B. Koroide
- C. Iris
- D. Retinë

77. Cilat komponime fitohen si produkte përfundimtare gjatë procesit të fotosintezës?

- A. Glukoza dhe dioksidi i karbonit
- B. Dioksidi i karbonit dhe uji
- C. Glukoza dhe oksigjeni
- D. Uji dhe oksigjeni

78. Cili është funksioni themelor i fshikëzës së ajrit te peshqit ?

- A. Hidrostatik
- B. Hidrodinamik
- C. Akustik
- D. Balistik

79. Çfarë dellëzimi kanë gjetet te bimët monokotiledone ?

- A. Rrjetore
- B. Paralele
- C. Dikotomike
- D. Spirale

80. Cili nga këto biome është i pasur me drunjtë të ahut?

- A. Tundra
- B. Savanat
- C. Pyjet halore
- D. Pyjet gjethgjera

